



Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Në mbështetje të nenit 11 (paragrafi 1.1), nenit 5 (paragrafi 1 pika 1.5), nenit 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenit 19 (paragrafi 11) të Rregullores nr. 01/2014 së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 20.01.2015, mori:

V E N D I M

I. Mbyllet rasti me nr. AKK-03-4108/14, për z.Musa Nikqi, Anëtar i Kuvendit Komunal të Komunës së Pejës, për shkak se zyrtari i lartë publik ka shmangur gjendjen e mundshme të konfliktit të interesit në të cilën ndodhej.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Në rastin e shqyrtuar për konflikt të interesit me numër protokolli AKK-03-4108/14, që për trajtim ka pasur zyrtarin z. Musa Nikqi, Anëtar i Kuvendit Komunal të Komunës së Pejës.

Gjatë zhvillimit të procedurës dhe pas vlerësimit të informatës së deponuar nga një palë anonime është konstatuar se zyrtari z. Musa Nikqi, gjatë kohës së ushtrimit të funksionit publik si zyrtar i lartë, anëtar i Kuvendit Komunal të Komunës së Pejës, është i angazhuar edhe si drejtor në shkollën e mesme "Bedri Pejani" në këtë Komunë e që sipas Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik Nr.04/L- 051, kjo situatë paraqet konflikt të mundshëm të interesit, dhe kufizim në ushtrimin të funksionit publik, po ashtu edhe neni 65.2 e Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 e ka parapa si ndalesë këtë situatë ku thotë drejtorët e institucioneve dhe ndërmarrjeve nën autoritetin e komunës dhe nëpunësit civil të administratës së komunës nuk mund të jenë anëtar të kuvendit të Republikës së Kosovës apo kuvendit të komunës të komunës ku ata punojnë.

Agjencia kundër Korrupsionit me datën 17.11.2014. e ka njoftuar zyrtarin e lartë me shkresën e parë se ka filluar procedura e shqyrtimit të gjendjes së mundshme të Konfliktit të Interesit dhe se ka të drejtë në afatin prej 15 ditësh të njoftohet me faktet që posedon Agjencia.

Pas kësaj shkrese z. Musa Nikqi, ka ardhur në takim ku është takuar me zyrtarët e AKK-së, dhe i janë prezantuar faktet që disponon Agjencia lidhur me çështjen e ngritur.

z. Nikqi, gjatë takimit është pajtuar me gjendjen, por na ka njoftuar se është vetëm duke e ushtruar funksionin e drejtorit të shkollës deri në zgjedhje të drejtorit të ri, pasi që është hapur një konkurs, dhe është zotuar se brenda afatit ligjorë do të marrë vendimin dhe do të jap dorëheqje nga njeri funksion.

Me datën 30.12.2014, kemi marr njoftimin nga z. Musa Nikqi, ku na njofton se ka dhënë dorëheqje nga funksioni i anëtarit të Kuvendit Komunal të Pejës, dhe tash e tutje do ta mbajë vetëm pozitën e drejtorit në Shkollën e Mesme "Bedri Pejani në Pejë.

Vlerësojmë se pas vendimit të marr nga z. Musa Nikqi, për të dhënë dorëheqje nga funksioni i anëtarit të Kuvendit Komunal dhe pas njoftimit që kemi pranuar nga pika kontaktuese e Komunës së Pejës për dorëheqjen e z. Nikqi nga funksioni i anëtarit të Kuvendit të Komunës së Pejës, konsiderojmë se është shmangur gjendjen e mundshme e konfliktit të interesit për zyrtarin z. Musa Nikqi, andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

II. Në mbështetje të nenit 18 (paragrafi 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik
- Drejtorit të DPK- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)
- Z./znj. (zyrtari kontaktues)

Hasan Preteni
Drejtör i Agjencisë kundër Korrupsionit

